

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët, Ragip Namani kryetar i kolegjit, Beshir Islami dhe Jelena Krivokapić, anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sherif Krasniqi, në çështjen juridike të palës ankuese;

H. Mehmeti , nga ..., Komuna ...

Kundër:

G. M. M., ..., R. Srbija

Palë kërkuese në Agjencinë Kosovare të Pronave,

Duke vendosur lidhur me ankesën e ushtruar, kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/78/2010, të datës 16 qershor 2010, (lënda e regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronave, me numër KPA35697, sipas kërkesës së palës kërkuese Goran Mančić), në seancën e mbajtur me datë, 26 Nëntor 2020, merr;

AKTGJYKIM

- 1. Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paraqitur nga H. M., kundër Vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/A/78/2010, të datës 16 qershor 2010, për sa i përket kërkesës të regjistruar në APK, me numër KPA35697.**
- 2. Vërtetohet Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/A/78/2010, i datës 16 qershor 2010, për sa i përket kërkesës së regjistruar me numër, KPA35697.**

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike;

1. Më datë 12 prill 2007 G. M., (tutje; pala kërkuese në AKP), ka paraqitur kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronave (tutje AKP), në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare,(ABF), të bartësit të drejtës pronësore (BDP), në emër të gjyshes së tij S. M., me të cilën kërkon ti njihet e drejta pronësore dhe ri posedimi i ngastrës kadastrale, nr...., në sipërfaqe prej 00.12.11ha, me kulturë arë e klasës së parë, e cilat ndodhet në vendin e quajtur, "...", Zona Kadastrale ..., Komuna Gjilan, e regjistruar në Fletën Poseduese nr. ..., (tutje prona e kërkuar).
2. Pala kërkuese në kërkesë kishte shënuar se, pronare e pronës së kërkuar është gjyshja e tij e cila posedimin e kishte humbur me datë 16 qershor 1999, si pasojë e rrethanave të viteve 1998/99, prona pastaj ishte uzurpuar në mënyrë të pa ligjshme nga NN persona. Kërkon ri posedimin dhe kompensimin për shfrytëzimin e saj, pa lejen paraprake të pronarit.
3. Në mbështetje të kërkesës, në AKP *inter alia*, kishte dorëzuar dokumentet si në vijim;

- Kopjen e Fletës Poseduese nr. ..., të datës 19.04.1984, sipas së cilës pronare e ngastrës kadastrale nr..., në sipërfaqe prej 00.12.11 ha, me kulturë arë, e klasës së parë, e cila ndodhet në vendin e quajtur “ ...”, Zona kad. ..., Komuna Gjilan, është M.S. (I.), e lindur I. (e veja e M.),me 1/1 pjesë ideale.
 - Certifikatën nga libri amë i të lindurve me nr. ..., të dt. ..., në emër të tij G. M..
 - Certifikatën nga libri amë i të vdekurve të babait të tij të ndjerë M. M. M.
 - Vendimin e trashëgimisë)-..., sipas së cilit pala kërkuese ka trashëguar pronë të pa luajtshme pas vdekjes së babait të tij, (nuk përfshihet prona lëndore e kërkuar).
4. AKP me datë 05.06.2008, kishte bërë njoftimin e kërkesës për pronën lëndore. Me datë 12 janar 2010, gjatë notifikimit nga vizita në pronën e kërkuar ishte gjetur se, e njëjta ishte tokë e punuar e uzurpuar nga H. M.,(tutje pala ankuese), i cili ishte prezent në kohën e vizitës. I njëjti pretendoi të drejtë ligjore për pronën lëndore dhe e nënshkruan formularin e njoftimit të pjesëmarrjes në procedurë si palë. Ai kishte deklaruar se, ishte i interesuar për ta blerë pronën e kërkuar, por ende nuk kishte arritur ndonjë marrëveshje me palën shitëse.
 5. Pala ankuese ishte kontaktuar nga sekretaria e AKP-së më datë 18 maj 2010, për tu vërtetuar se mbi çfarë baze ishte duke e shfrytëzuar pronën e kërkuar, i njëjti kishte deklaruar se është i interesuar për ta blerë por jo menjëherë dhe se ishin gjashtë vëllezër që duhej konsultuar për këtë. Në kontaktin tjetër me datë 31 maj 2010, kishte deklaruar se ai ka folur me palën kërkuese në telefon, i cili i kishte thënë se, është i interesuar për ta shitur por paraprakisht duhet të marrë pëlqimin e axhallarëve të tij. Sekretaria po ashtu kishte vërejtur se pala ankuese nuk i kishte përshkruar qartë pronat të cilat dëshiron ti blejë e as madhësinë e tyre, dhe asnjë dëshmi dokumentuese sipas pretendimeve të tij.
 6. Pala kërkuese në AKP, po ashtu ishte kontaktuar nga sekretaria e AKP-së, më datë 27 maj 2010, i njëjti kishte deklaruar se ai nuk e njeh palën ankuese dhe asnjëherë me te nuk kishte kontaktuar apo negociuar për t’ia shitur pronën lëndore por kishte theksuar se është e mundur që ndokush nga anëtarët e familjes së tij të ketë biseduar me ate.
 7. Sipas raportit të konsoliduar të verifikimit të AKP-së, të dt. 25.03.2010, dokumentet personale të paraqitura nga pala kërkuese në AKP, edhe ato pronësore lidhur me pronën lëndore, *ex officio* ishin verifikuar pozitivisht si ekzistuese. Në Departamentin e kadastrit në Gjilan me dt. 17.12. 2009, ishte verifikuar pozitivisht Certifikata e të drejtave pronësore CDP me nr. UL-...,e dt. 25.06.2008 për ngastrën kadastrale lëndore me numër ..., e cila ishte e evidentuar në emër të pronares S. M., me 1/1, pjesë ideale.
 8. Më datë 16 qershor 2010, KKPK me vendimin e vet grupor KPCC/D/A/78/2010, që aplikohet për kërkesën lëndore KPA35697, të palës kërkuese G. M., dhe pronën lëndore ngastrën kad. ..., në sipërfaqe prej 00.12.11ha, kishte vendosur se, pala kërkuese e kishte dëshmuar se S. M. është pronar me 1/1 pjesë ideale, të pronës së kërkuar, andaj e njëjta ka të drejtë në posedimin e pronës në fjalë ,ndërsa çdo person që e ka uzurpuar pronën duhet ta liroj brenda afatit prej 30 ditë. Komisioni kishte vendosur po ashtu se kërkesa për

komensim të dëmit fizik apo humbjes së shfrytëzimit të pronës, të refuzohet me që komisioni nuk ka mandat mbi kërkesat e tilla. Arsytimi epet në paragrafët (paragrafët 11-15), të këtij vendimi grupor për kërkesën lëndore, ku ndër të tjera theksohet se, pala kërkuese e ka dëshmuar të drejtën pronësore të BDP në bazë të fletës poseduese e cila është verifikuar pozitivisht nga sekretaria edhe *ex officio*, ndërsa pala përgjegjëse,(tani ankuese), nuk kishte paraqitur mbrojtje juridike të vlefshme sipas pretendimeve të tij. Ai nuk kishte siguruar ndonjë dokument në mbështetje të kërkesës, megjithatë ai kishte pohuar se është i interesuar për blerjen e pronës, nëse bashkëpronarët e tjerë të cilët janë të afërm të ushtruesit të kërkesës janë dakord ti shesin ato.

9. Më datë 27.09.2010, KKPK, kishte nxjerrë Vendimin individual të vërtetuar për kërkesën KPA35697, lidhur me pronën lëndore, ngastrën kad. ..., i cili e përmban mënyrën e vendosjes si në vendimin grupor nr. KPCC/D/A/78/2010, të dt. 16.06.2010. Në këtë vendim nuk paraqitet asnjë palë përgjegjëse në kërkesë lidhur me pronën lëndore.
10. Më datë 02 mars 2011, vendimi i KKPK-së, i ishte dorëzuar palës kërkuese në AKP, G. M., ndërsa palës ankuese H. M. me datë 05 korrik 2011. Kundër këtij Vendimi asnjëra palë nuk kishte ushtruar ankesë në afatin e paraparë ligjor prej 30 ditë.
11. KKPK më datë 29 maj 2017, kishte nxjerrë vendimin tjetër individual, lidhur me kërkesën lëndore KPA35697, në emër të palës kërkuese G. M., me të cilin e kishte bërë korrigjimin e vendimit të saj të më parshëm individual, të dt. 27.09.2010, ku tani si palë përgjegjëse, në kërkesën e palës kërkuese, paraqitet pala ankuese H. M..
12. Më datë 14 shkurt 2018, vendimi i korrigjuar i dt. 29 maj 2017, lidhur me kërkesën KPA35697, i ishte dorëzuar palës ankuese H. M., i njëjti me datë 14 mars 2018, në cilësinë e palës përgjegjëse në kërkesë të palës kërkuese, ka paraqitur ankesë, duke e plotësuar formularin e ankesës të ofruar në shkallën e parë në AKP.
13. Me datë 01.06.2017, vendimi i njëjtë i është dorëzuar Agjencisë Kadastrale të Kosovës, ndërsa në shkresa të lëndës nuk ka dëshmi se i është dorëzuar palës kërkuese në AKP.
14. Më datë 14 qershor 2018, ankesa e palës ankuese për paraqitjen e përgjigjes i është dërguar për mes shërbimit postar, palës kërkuese në AKP G. M., megjithatë në afatin e paraparë ligjor prej 30 ditë, nuk është dëshmuar se i njëjti ka paraqitur përgjigje në ankesë.

Pretendimet e palës ankuese;

15. Pala ankuese vendimin e ankimuar e konteston për shkak të; vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të drejtës materiale , në arsyetim thekson se, pronën lëndore –ngastrën kad. ..., e ka blerë nga S.M., se nga AKP nuk janë marrë parasysh deklaratat e dëshmitarëve që ishin prezent gjatë shitblerjes së parcelës.

16. **Ankesës i bashkëngjet;**

- Deklaratën e tij të përpiluar tek avokat Rr. L. në ..., më datë 07.03.2018, në të cilën ndër të tjera thekson se, pronën lëndore e kanë blerë në vitin 1992 prej S. M., nga ..., të cilit i është bërë pagesa në tërësi, po ashtu thekson se ndaj tij është ngrit aktakuza PP.II.623/2014, me dt.29.04.2014, kinse ka bërë uzurpim të pa ligjshëm të pronës lëndore por është liruar nga përgjegjësia penale në mungesë të provave, se kohë më parë ka kërkuar nga APK që si pronar faktik ti njihet e drejta pronësore, sepse e ka ende në shfrytëzim.
- Deklaratën e përbashkët të dëshmitarëve, G.H. dhe R. H. nga ..., të noterizuar më dt. 11.03.2018, të cilët dëshmojnë njëjtë si pala ankuese në deklaratën e tij se, ai e ka blerë pronën lëndore dhe një ngastër tjetër në vitin 1992, nga S. M., në prezencën e tyre.
- Fotokopjen e certifikatës së vdekjes në emër të S. M. me nr. reference ..., të dt. 01.02.2016, nga e cila shihet se e ndjera ka vdekur me datë 08.07.1983, në Gjilan.
- Fotokopjen e Listës poseduese nr. ..., të dt. 19.04.1984, në emër të M. S. (I.) e lindur I.,(e veja e M.), e cila përmban ndër tjera edhe pronën lëndore,(ngastrën kad. nr. ...).
- Fotokopjen e letër njoftimit të M. M. S. nr. ..., të dt. 18.03.1989 lëshuar nga SPB ...
- Fotokopjen e Letërnjoftimit të tij.
- Kontratën e shitblerjes të pronës lëndore, të dt. 13.04.1992, të pa vërtetuar në gjykatë, (e hartuar në gjuhë serbe), e lidhur në emër të ndjerës S., nga trashëgimtarët e saj M. M1. P. , M. M2. M. ,M3. S. M., M. S. V., M. M4. S. të gjithë nga ..., si shitës, dhe blerësit H. I. M..

Afatshmëria dhe lejueshmëria e ankesës;

17. Ankesa e ushtruar nga pala ankuese H. M. është e afatshme, është paraqitur brenda 30 ditëve, pas pranimit të Vendimit të korigjuar të KKPK-së, ashtu si parashihet me nenin 12.1 të Rreg. së UNMIK-ut nr. 2006/50, mbi zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079.
18. Po ashtu ankesa pranohet si e lejueshme, sepse pala ankuese kishte marrë pjesë në procedurën e zhvilluar në shkallën e parë, duke e nënshkruar njoftimin e pjesëmarrjes në AKP më datë 12 janar 2010 dhe duke komunikuar me këtë organ lidhur me pronën lëndore, megjithatë në vendimin individual të KKPK, të dt. 27.09.2010, ai nuk ishte i përfshirë si palë përgjegjëse në procedurën e zhvilluar në APK.
19. Sipas nenit 10.2, të Rregullores nr. 2006/50, e ndryshuar me Ligjin, nr. 03/L-079, parashihet se çdo person tjetër për pos paraqitësit të kërkesës i cili aktualisht pretendon mbi pronën e kërkuar, do të jetë palë në kërkesë dhe procedurë lidhur me atë kërkesë, me kusht që personi i tillë të informoj AKP-në , për synimet e tij që të merr pjesë në procedurë.
20. Me vendimin e korigjuar individual të KKPK-së, të datës 29 maj 2017, është bërë korigjimi e vendimit të më parshëm individual i datës 27.09.2010, i cili vendim është anuluar dhe tani si palë përgjegjëse paraqitet pala ankuese.
21. Kolegji i Gjykatës Supreme nga këto fakte vlerëson se, korigjimi i vendimit të më parshëm nuk mund të trajtohet se kishte të bënte vetëm me gabim tekstual apo të natyrës formale, sepse

me te ai i më parëmi është nxjerrë jashtë fuqie dhe tani me vendimin e ri, si palë përgjegjëse në procedurë të shkallës së parë në AKP, është pranuar pala ankuese H. M., të cilit i është dorëzuar ky vendim origjinal i vërtetuar si fakti i ri, i ndryshëm nga vendimi i parë, (Shih edhe shkresat-sqaruese të AKP-së, dërguar palëve, faqe 134-142, në shkresat e lëndës). Nga ky fakt kërkesa e palës kërkuese në AKP, nuk mund të trajtohet si jo kontestuese sepse kontestohet nga pala ankuese. Mbi këtë parim Gjykata Supreme vlerëson se palës ankuese nuk duhet ti mohohet e drejta në ankesë, prandaj ankesa është e pranueshme, ashtu si parashihet edhe në kuptim të nenit 165 par. 3 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, (ligji Nr. 03/L-006), ligj i zbatueshëm në procedurën e vendosjes së kolegjit të Gjykatës Supreme, sepse e drejta dhe afati në ankesë rrjedh prej vendimit të korrigjuar me të cilin tani është pranuar si palë në procedurë në AKP pala ankuese, përkatësisht prej ditës së pranimit të këtij vendimi.

Meritat e ankesës,

Arsyetimi ligjor

22. Gjykata Supreme pasi shqyrtoi theksimet në ankesë, vendimin e ankimuar, dhe përmbajtjen e shkresave të lëndës, gjen se ankesa është e papabuar, ndërsa vendimi i KKPK-së, është i drejtë dhe ligjor. Gjykata nuk gjeti prova se Vendimi i ankimuar është i përfshirë me vërtetimin jo të plotë apo të gabuar të fakteve lidhur me gjendjen faktike, ashtu si thekson pala ankuese dhe as me zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe procedurale.
23. Sipas nenit 3.1 Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë në një urdhëresë nga Komisioni për ri-posedim të pronës, nëse paraqitësi i kërkesës jo vetëm që dëshmon pronësinë e pronës së paluajtshme private, por edhe që ai nuk është në gjendje aktualisht t'i ushtrojë këto të drejta pronësore për shkak të rrethanave që ndërlidhen drejtpërsëdrejti apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ka ndodhur në Kosovë, ndërmjet 27 Shkurtit 1998 dhe 20 Qershorit 1999.
24. Pasi që paraqitësi e kërkesës e cek se data e humbjes së posedimit në pronën e kërkuar është Qershori i vitit 1999, kërkesa ka të bëjë me rrethanat që ndërlidhen drejtpërsëdrejti me, apo rezultojnë nga konflikti i armatosur në Kosovë, dhe me që i njëjti e ka dëshmuar të drejtën pronësore, në emër të gjyshes së tij e në anën tjetër nuk është dëshmuar se prona e kërkuar është shitur, nga këto fakte kërkesa e tij nga KKPK-ja, me të drejtë është vendosur në favor të tij.
25. Gjykata Supreme pajtohet me vendimin e KKPK-së, sepse pala ankuese përderisa pretendon të drejtë ligjore ndaj pronës kontestuese, nuk ka paraqitur dokumentacion apo ndonjë informacion tjetër valid në mbështetje të drejtës së tij, as në kohën e njoftimit të pronës, apo gjer në vendosjen në shkallën e parë nga KKPK-ja, dhe as tani me ankesë, përkundër faktit se atij i është dhënë mundësia e tillë. I njëjti për veç se është deklaruar për mes kontakteve me AKP-në, me datë 18 dhe 31 Maj 2010, se ai është i interesuar për ta blerë pronën lëndore, nuk ka ofruar asnjë dëshmi me vlerë juridike që do të argumentonin një transaksion të shitblerjes.

26. Pretendimet në ankesë të cekura si më lartë, e në veqanti theksimet se, pronën lëndore e ka blerë nga S. M. në vitin 1992, të cilit ja ka bërë pagesën e qmimit në vendin ku i është treguar sipërfaqja e pronës, ndërsa komisioni i APK-së nuk e ka marrë për bazë këtë fakt dhe as deklaratat e dëshmitarëve G. dhe R. H., të cilët ishin prezent kur është bërë shitblerja etj., kolegji i Gjykatës Supreme i shqyrtoi me kujdes dhe i vlerëson se nuk janë të qëndrueshme, të bazuara, apo me ndikim për vendosjen ndryshe të kësaj çështje, sepse në shkallën e parë në AKP, nuk provohet me asnjë fakt se pala ankuese është deklaruar se e ka blerë pronën lëndore në vitin 1992 nga një familjar tjetër të BDP, ashtu si e thekson tani në ankesë, por i njëjti kishte deklaruar se e ka në posedim dhe ishte i interesuar për ta blerë. Deklarata e tij dhe dëshmitarëve janë të vitit 2018, por sidoqoft deklaratimet eventuale të dëshmitarëve nuk do të ishin mbrojtje valide dhe nuk janë dokumente të mjaftueshme në bazë të cilave mund të konstituohet pronësia, gjer sa në anën tjetër në departamentin e kadastrit në Gjilan, sipas Certifikatës të Drejtave Pronësore CDP, me nr. UL-70403020-00354,(e verifikuar pozitivisht nga sekretaria e APK-së), ngastra kadastrale lëndore me numër 1709, ishte e regjistruar në emër të BDP Stana Mančić, me 1/1 pjesë ideale.
27. Kontrata e shitblerjes të cilën tani e paraqet pala ankuese me ankesë, të cekur si në parag.16 pika 7, të këtij aktgjykimi), që pretendohet se është lidhur me datë 13.04.1992, në mes tij si blerës dhe shitësve si në nenin 1., të kësaj kontrate , (e cila si dëshmi nuk ishte paraqitur fare në procedurën e zhvilluar në shkallën e parë në AKP), nuk mund të pranohet si dokument valid, sepse është e pa vërtetuar në gjykatë, e pa nënshkruar nga pala blerëse, e po ashtu palët shitëse nuk dëshmojnë se ishin shpallur trashëgimtar, apo me një bazë tjetër ishin pronar të pronës lëndore për të pasur të drejtë ta shesin atë.
28. Bazuar në legjislacionin në fuqi konkretisht nenin 33 të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Juridike-Pronësore (GZ RSFJ, Nr.6/80) përcaktohet se, në bazë të veprimit juridik e drejta e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme fitohet me regjistrimin në regjistrat publik ose në mënyrën tjetër përkatëse të caktuar me ligj. Edhe Ligji aktual nr. 03/L-154, Për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore, në nenin 36 pika 1, e parasheh se, “Për bartjen e pronësisë në paluajtshmëri është e nevojshme një punë juridike e vlefshme ndërmjet tjetërsuesit dhe fituesit, si bazë juridike dhe regjistrimi i ndryshimit të pronësisë në Regjistrin e të drejtave në paluajtshmëri”.
29. Është e evidente se në çështjen në shqyrtim nuk dëshmojnë me asnjë provë relevante se ka ndodhur një transaksion valid me një punë juridike ligjore, lidhur me pronën kontestuese në mes të palës ankuese dhe palës kërkuese në APK, ashtu si parashihet me dispozitat ligjore të cituara si në paragrafin paraprak.
30. Sipas nenit 12.11, të Rreg. nr. 2006/50, e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, faktet e reja dhe dëshmitë materiale të paraqitura nga cilado palë lidhur me ankesë, nuk pranohen dhe nuk shqyrtohen nga Gjykata Supreme, përpos nëse dëshmojnë se dëshmitë e tilla me arsye nuk kanë mundur të jenë të njohura për palën në fjalë. Bazuar në këtë dispozitë ligjore kolegji vlerëson se pala ankuese megjithatë me ankesë nuk ofron asnjë dëshmi valide me vlerë

juridike, për veç që thirret në deklarata të dëshmitarëve dhe në kontratën e shitblerjes të cekur edhe më lartë, e cila nuk mund të pranohet si valide për shkak të metave të saj ligjore, por edhe sikur të ishte valide me asnjë provë pala ankuese nuk e provon pse nuk e ka paraqitur në procedurën e zhvilluar në shkallën e parë në AKP.

31. Nga faktet e lartpërmendura rezulton se gjendja faktike në këtë çështje juridike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë andaj konfirmimi i vendimit të KKKP-së, nuk është sjellë në dyshim nga theksimet në ankesë, sepse nuk bazohen në asnjë provë të vlefshme juridike.
32. Në bazë të lartcekurave dhe në lidhje me nenin 13.3 (c) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë ligjore:

33. Sipas nenit 13.6, të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm ,andaj nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË
GSK-KPA-A-014-2018, me datë 26 Nëntor 2020

Bashkp. Profesional,
Sherif Krasniqi

Kryetari i Kolegjit,
Ragip Namani